



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 320 Prot.

Tiranë, më dt. 31.05.2018

VENDIM

Nr.226, dt. 31.05.2018

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 31.05.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi i “HEC LISECI”, në lumin e Holtës, në fshatin Çerkezë, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”, me subjekt aplikues “ERGI PINK” sh.p.k.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Banesa e Toli Dedës”, Gramsh.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Mirela Kumburo Furxhi



SEKRETAR I KKR

Arta Dollani